

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës- SHERBIM

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Pastrimi i Kolektorëve të Ujërave të Ndotura në Sarandë dhe Ksamil”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Sherbimet e inspektimit te tubacioneve CPV 76600000-9

VLERA E FONDIT LIMIT: 6 709 510(gjashtëmilion shtatëqind e nëntëmijë e pesëqind e dhjetë) pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor *Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarande sh.a* ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimi sipas shtojcës 9)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2020, 2021 dhe 2022) lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa 30% të vlerës së përllogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 30 % të vlerës së përllogaritur të kontratës

Kjo procedurë është nën kufirin ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklaramin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare është sa 30% e vlerës së parashikuar të loteve që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2020, 2021 dhe 2022 ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e këtij kriteri, ne menyre qe t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesemarrës te mundshem ne procedure.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të ligjit nr.25/2018 ”Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë sa 20% të vlerës së përlllogaritur dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë sa 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Liçencat profesionale që duhet të plotësojnë pjesëmarrësit, në varësi të llojit të punimeve për këtë objekt, do të jetë:

NP-7 Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje.

NP-12 Punime të inxhinierisë mjedisore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin , si më poshtë:

- a) 1 (një) Inxhinier Mjedisi (**i cili duhet të jetë drejtues teknik në licencën e shoqërisë**)
- b) 1 (një) Inxhinier Ndërtimi/Hidro me kontrate

Inxhinieret e mësipërm duhet të jenë të jenë të siguruar dhe të figurojnë me kohë të plotë në listëpagesat përkatëse E-Sig për të paktën muajin e fundit

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratën individuale të punës
- Diplomën e inxhinierëve
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe Nenit 41, Pika 4/b VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike. Nevoja për inxhinierët në objekt është

e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 13 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3.4/1 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a) 5 (pese) shofer
- b) 6 (gjashte) puntorë te kualifikuar

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar muaji i fundit
- Kontratën individuale të punës të vlefshme;
- Dokumentacionin që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar në këtë kriter. (diplomë/certifikatë e arsimit profesional).

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës duke dorëzuar listapagesat për periudhën e kërkuar. Konkretisht:

- Numri i fuqisë punëtore u llogarite duke u bazuar në volumin e punimeve që duhen kryer sipas projekt-preventivit dhe afatit 2 vjeçar për kryerjen e punimeve. Në bazë të orëve të punës të marra nga analizat për secilin ze, u llogarite shifra prej 13 punonjës.

- Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialistë i fushës ka bërë një analizë bazuar tek kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën.

- Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

- Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrate tatimore me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1.	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes (mbi 12 Ton)	Pronesi ose me qera	Copë 1
2.	Automjet teknologjik per pastrimin e kolektoreve te bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartes jo me pak se 9 ton, me ndarje membrane te levizshme (ndryshim volumi uje/material i ngurte), e pajisur me pompe pastrimi me presion pune jo me pak se 270 bar, prurje jo me pak se 330 litra/minut dhe dy sonda me gjatesi me te madhe se 80m, e pajisur me pompe vakumi per thithjen e materialeve te ngurta me kapacitet jo me te vogel se 1200 m ³ /ore.	në pronësi ose me qira	Copë 1
3.	Automjet teknologjik per pastrimin e kolektoreve te bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartes jo me pak se 2 ton, me ndarje membrane te levizshme (ndryshim volumi uje/material i ngurte), e pajisur me pompe pastrimi me presion pune jo me pak se 150 bar, prurje jo me pak se 100 litra/minut dhe dy sonda me gjatesi me te madhe se 50m, e pajisur me pompe vakumi per thithjen e materialeve te ngurta me kapacitet jo me te vogel se 250 m ³ /ore.	në pronësi ose me qira	Copë 1
4.	Automjet teknologjik per pastrimin e pusetave te kolektoreve te KUZ dhe KUSH dhe pusetave te shiut e pajisur me bot me kapacitet bartes jo me pak se 4 ton, e pajisur me kove hidraulike per ngarkimin e materialeve te ngurta dhe vinc me kapacitet ngrites jo me pak se 0.3 ton.	në pronësi ose me qira	Copë 1
5.	Automjet teknologjik per inspektimin e kolektoreve me diameter (100÷2000) mm e pajisur me dy ose me	në pronësi ose me qira	Copë 1

	shume sisteme kamerash per gjatesi inspektimi jo me pak se 200 m		
6.	Motopompe per largimin e ujrave te ndotura me prurje deri ne 4000 litra/minut, dhe presion pune jo me te vogel se 8 bar.	në pronësi ose me qira	Copë 1

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës dhe objekti.
- iv. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 41/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme të shoqërisë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKL për transportim e depozitim të mbetjeve (kodi III.2.B).

Argumentimi: Siç evidentohet qartë dhe nga koncepti i kësaj procedure, përmbushja e kësaj pike në kriteret e kërkuara është në përputhje me kërkesat e nenin 41 pika a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, si një dokument ligjor për përmbushjen e shërbimit të kërkuar në procedurën e tenderit, është tepër i rëndësishëm dhe AK duhet të krijojë besueshmëri të lartë së OE do të ketë kompetencat dhe licencimin e duhur në kuadër të rekomandimeve dhe planeve të gadishmërisë në rastet e emergjencave dhe për të parandaluar forcat madhore. Licenca e kërkuar me sipër specifikon veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme, lidhur ngushtesisht me aftësinë teknike të OE për procedurën në fjalë, pasi kërkohet që në fund të shërbimit, materiali i gjeneruar nga pastrimi i kolektorëve kërkon vëmendje maksimale për të menaxhuar situatat kritike mjedisore me ndikime të perkoheshme apo të përhershme, për të cilat Instucionet përgjegjëse ngarkojnë me përgjegjësi Operatorin e shërbimit dhe në rastin me të keqe mund të ndërpresin dhe shërbimin e kontraktuar.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- ISO 9001:2015 *Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë* ose ekuivalente (e vlefshme)
- ISO 14001-2015 *Sistemet e Menaxhimit Mjedisor* ose ekuivalente (e vlefshme)

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, citon: “Autoriteti/entë kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

AK vendosi të kërkojë certifikatat e mësipërme për të vërtetuar cilësinë e punimeve që do të kryen nga O.E fitues. Certifikatat e kërkuara janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe respektojnë parimin e mosdiskriminimit.

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTIVI.

Objektivi i këtij projekti është përmirësimi i rrjetit të ujërave të ndotura për zonat e shqyrtuara më sipër nëpërmjet pastrimit të mbeturinave të ngurta (aluvione, plastikë, tekstile etj;) që gjenden të pranishme në kolektorët kryesorë të ujërave të ndotura. Matja e njësisë së punës për pastrimin e kolektorëve do bëhet në ml sipas gjatesise te tubacionit të pastrimit te percaktuar qarte ne preventivin e hartuar nga Autoriteti Kontraktor.

QËLLIMI I INVESTIMIT.

Qëllimi i objektit është rritja e kapacitetit përcjellës të tubacioneve të ujërave të ndotur rikthimi i tyre në gjendje optimale, minimizimi i fenomenit të përmytjeve si dhe rritje të cilësisë së jetës. Projekti konsiston në largimin e papastërtive me makineri autobot teknologjik me sonda presioni për lëvizjen e aluvioneve brenda në tubacion dhe më pas transportin e këtyre mbeturinave me automjete të posacme, me kazan të mbyllur për të mos ndotur ambientin. Etapat e punës së autobotit janë të ilustruara në skemat e mëposhtme, e cila fillon me procesin e futjes së sondës së presionit në tubacionin e ujërave të ndotura, tërheqjen e aluvioneve në pusetën e kontrollit me anë të krikut hidraulik dhe më pas thithjen e tyre me autobotin e vakumit dhe transportin e tyre në vendgrumbullim të miratuar.

KAPITULLI 1

TË PËRGJITHSHME

1.1 Të përgjithshme

Paragrafët në këtë kapitull janë plotësuese të detajeve të dhëna në Kushtet e Kontratës.

1.2 Zëvendësimet

Zëvendësimi i materialeve të specifikuara në Dokumentin e Kontratës do të bëhen vetëm me aprovimin e Mbikqyrësit të Punimeve në se materjali i propozuar për tu zëvendësuar është i njëjtë ose më i mirë se materialet e specifikuara ; ose në se materialet e specifikuara nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e Kontratës për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Sipërmarrësit. Që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë, në formën e kuotimit të certifikuar dhe të datës së garancisë të dorëzimit nga furnizuesit e të dy materialeve, si të materialit të specifikuar ashtu edhe të atij që propozohet të ndryshohet.

1.3 Dokumentat dhe vizatimet

Sipërmarrësi do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasi dhe detajet të treguar në Vizatimet, ose të dhëna të tjera dhe Punëdhënësi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to. Sipërmarrësi do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në berjen e llogaritjeve të madhësive , llojeve dhe sasive të materialeve dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet bërë sipas Kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mospërputhje, ndërsa një udhëzim i plotë do të jepet nga Punëdhënësi në se gabime të tilla ose mospërputhje do të zbulohen.

1.4 Kostot e Sipërmarrësit për mobilizim dhe punime të përkohëshme

Do të kërket parasysh që Sipërmarrësit nuk do të behet asnjë pagesë mbi cmimet njësi të kuotuar për kostot e mobilizimit d.m.th. për sigurimin e transportit, drite, energji, veglat dhe pajisjet, ose për furnizimin e godines dhe mirembajtjen e impianteve të ndërtimit, rrugëve të hyrjes, të komoditeteve sanitare heqje e mbeturinave, punën, furnizimin me ujë, mbrojtjen kundër zjarrit, bangot e punës, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura të tjera të përkohëshme, pajisje dhe materialet, ose për kujdesin mjekësor dhe mbrojtjen e shëndetit, ose për patrullat dhe rojet, ose për ndonjë shërbim tjetër, lehtësi, gjera, ose materialet të nevojshme ose që kërkojnë për zbatimin e punimeve në përputhje me ato që është parashikuar në Kontratë.

1.5 Organizimi i Punimeve

Sipërmarrësi duhet të organizojë punën për ndërtimin, mirembajtjen dhe me pas të spostoje dhe ta rivendosë çdo rrugë hyrje që do të duhet në lidhje me zbatimin e punimeve. Çvendosja do të përfshijë përshatjen e zonës me çdo rrugë hyrje dhe se paku me shkallë sigurie, qëndrueshmëri dhe të kullimit të ujërave sipërfaqësore të njëjta me ato që ekzistonte përpara se Sipërmarrësi të hynte në Shesh.

1.6 Furnizimi me ujë

Uji, që nevojitet për zbatimin e punimeve, do të merret nga rrjeti kryesor nepermjet një matesi në pikën me të afert të mundshme. Sipërmarrësi do të shtrijë rrjetin e vet të përkohëshëm të tubacioneve. Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot për këto do të paguhet nga Sipërmarrësi. Në rastet kur nuk ka mundësi lidhje me rrjetin kryesor, Sipërmarrësi duhet të bejë vetë përpjekjet për furnizimin me ujë higjienikisht të pastër dhe të pijshëm për punetoret dhe punimet.

1.7 Furnizimi me energji elektrike

Sipermarresi do te beje perpjekjet dhe me shpenzimet e tij per furnizimin me energji elektrike ne kantjer, si me kontraktim me KESH – in, kur lidhjet me rrjetin kryesor lokal jane te mundura, ose duke parashikuar gjeneratorin e vet per te permbushur kerkesat.

1.8 Bashkepunimi ne zone

Ndertimi do te behet ne zona te kufizuara. Sipermarresi duhet te kete vecanerisht kujdes ne:

a)nevojen per te mirembajtur sherbimet ekzistuese dhe mundesite e kalimit per banoret dhe tregetaret qe jane ne zone, gjate periudhes se ndertimit.

b) prezencen e mundeshme te kontraktoreve te tjere ne zone me te cilet do te koordinohet puna

E gjithë puna, do te behet ne nje menyre te tille, qe te lejoje hyrjen dhe perballimin e te gjithë pajisjeve te mundeshme per ndonje Kontraktor tjetër dhe punetoreve te tij, stafin e Punedhenesit si edhe te cdo punojnjesi qe mund te punesohet ne zbatim dhe/ose punimet ne zone ose prane saj per cdo objekt qe ka lidhje me Kontraten ose cdo gje tjetër.

Ne pregatitjen e programit te tij te punes, Sipermarresi gjate gjithë kohes do te beje llogari te plote dhe do te koepereje me programin e punes se Kontraktoreve te tjere, ne menyre qe te shkaktoje nje minimum interference me ta dhe me publikun.

1.9 Mbrojtja e punes dhe e publikut

Sipermarresi do te mare masa paraprake per mbrojtjen e punetoreve te punesuar dhe te jetes publike si edhe te pasurive ne dhe rreth sheshit te ndertimit. Masat e sigurimit paraprak te ligjeve te aplikushme, kodeve te ndertesave dhe te ndertimit do te respektohen. Makinerite, pajisjet dhe cdo rrezik do te kqyren ose eliminohen ne perputhje me masat paraprake te sigurimit.

Gjate zbatimit te punimeve Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet te vendosi dhe te mirembaje gjate nates pengesa te tilla dhe drita te cilat do te parandalojne ne menyre efektive aksidentet. Sipermarresi duhet te siguroje pengesa te pershtateshme, shenja me drite te kuqe “rrezik” ose “kujdes” dhe vrojtues ne te gjitha vendet ku punimet mund te shkaktojne crregullime te trafikut normal ose qe perbejne ne ndonje menyre rrezik per publikun..2

1.10 Mbrojtja e ambientit

Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet te ndermarre te gjithë veprimet e mundshme per te siguruar qe ambjenti lokal i sheshit te ruhet dhe qe vijat e ujit, toka dhe ajri (duke perfshire edhe zhurmat) te jene te pastra nga ndotja per shkak te punimeve te kryera . Mos plotesimi i kesaj klauzole ne baze te evidentimit nga Mbikqyresi i Punimeve, mund te coje ne nderprejren e kontrates.

1.11 Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i cdo materiali nga Sipermarresi do te behet me makina te pershtateshme te cilat kur ngarkohen nuk shkaktojne derdhje dhe e gjithë ngarkesa te jete e siguruar. .Ndonje makine qe nuk ploteson kete kerkese ose ndonje nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do te hiqet nga kantjeri. Te gjitha materialet qe sillen nga Sipermarresi, duhet te stivohen ose te magazinohen ne menyre te pershtateshme per ti mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe ne dispozicion, per tu kontrolluar nga Mbikqyresi i Punimeve ne çdo kohe.

1.12 Sheshi per magazinim

Sipermarresi duhet te beje me shpenzimet e tij marrjen me qira ose blerjen e nje terreni te mjaftueshem per ngritjen e magazinave me shpenzimet e tij.

1.13 Pastrimi përfundimtar i zonës

Në përfundim të punës, sa here qe eshte e aplikueshme Sipermarresi, me shpenzimet e tij, duhet te pastroje dhe te heqe nga sheshi te gjitha impiantet ndertimore, materialet qe kane tepruar, mbeturinat, larje me presion te sheshit te pastrimit me makineri autonot te cdo lloji hapsire qe ndote dhe ta lere sheshin dhe veprat te pastra dhe ne kondita te pranueshme. Pagesa perfundimtare e Kontrates do te mbahet deri sa kjo te realizohet dhe pasi te jepet miratimi nga Mbikqyresi i Punimeve.

2. KAPITULLI II

Pastrimet e Kolektoreve

SPECIFIKIMET TEKINKE TE MJETE TE PROCEDURES

Pastrimet e tubacioneve te betonit dhe HDPE do te kryhen me ane te makinerive autobot teknologjik me pompë presionit të lartë 170-275 bar i cili te jete i paisur dhe me pompe per thithjen e llumrave.

Cmimi njesi i zerave te punes per pastrim do te perfshine, por nuk do te kufizohen per pastrime ne te gjithë gjeresine dhe thellesine, me cdo mjet qe te jete i nevojshem, duke perfshire pastrimin me dore.

Cmimi njesi eshte i percaktuar ne baze te oreve te punes se makinerise dhe stafit. Makinerite me te perdorura ne pastrimin e kolektoreve jane: autoboti teknologjik me presion, makin teknologjike pastrami dhe transporti për mbetjet e pusetave, si dhe mjete te tjera ndimese.

1. Autobot teknologjik

- Automjet teknologjik per pastrimin e kolektoreve te bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartes jo me pak se 9 ton, me ndarje membrane te levizshme (ndryshim volumi uje/material i ngurte), e pajisur me pompe pastrimi me presion pune jo me pak se 270 bar, prurje jo me pak se 330 litra/minut dhe dy sonda me gjatesi me te madhe se 80m, e pajisur me pompe vakumi per thithjen e materialeve te ngurta me kapacitet jo me te vogel se 1200 m³/ore.

2. Automjet teknologjik

- Per pastrimin e kolektoreve te bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartes jo me pak se 2 ton, me ndarje membrane te levizshme (ndryshim volumi uje/material i ngurte), e pajisur me pompe pastrimi me presion pune jo me pak se 150 bar, prurje jo me pak se 100 litra/minut dhe dy sonda me gjatesi me te madhe se 50m, e pajisur me pompe vakumi per thithjen e materialeve te ngurta me kapacitet jo me te vogel se 250 m³/ore

3. Automjet teknologjik

Per pastrimin e pusetave te kolektoreve te KUZ dhe KUSH dhe pusetave te shiut e pajisur me bot me kapacitet bartes jo me pak se 4 ton, e pajisur me kove hidraulike per ngarkimin e materialeve te ngurta dhe vinc me kapacitet ngrites jo me pak se 0.3 ton.

- 4. Auto Vinc** me kapacitet mbajtes 12 ton, me komando mbi 15 m I pajisur autokomandues me peshe te kokes min 1 ton.

5. Automjet teknologjik

Per inspektimin e kolektoreve me diameter (100÷2000) mm e pajisur me dy ose me shume sisteme kamerash per gjatesi inspektimi jo me pak se 200 m

- 6. Kamion ose Kamoncine Auto Pastruese** me kapacitet 7.5m³ me turbina thithje.

7. **Kamion veteshkarkues** me kapacitet mbajtes (mbi 12 Ton)
8. **Motopompe** per largimin e ujrave te ndotura me prurje deri ne 2500 litra/minut, dhe presion pune jo me te vogel se 4 bar.
9. **Specifikimet teknike te Kokave te sondave te Autoboteve te pastrimit**

Kokat e sondave duhet te jene si me poshte:

Nr.	Diametrii/ pol	Litra /Minut	Dimensioni	Gjatesia e Pastrimit te tubit ne ml	Pesha e sondes// koka ne kg
1	1'	250	150-200	10000	5.5
2	1 1/4'	320	200-315	5000	12
3	1 1/4'	400	200-315	27000	5
4	1 1/4'	350	315-500	15000	32
5	1 3/4'	250	315-600	6000	54
6	1 3/4'	250	400-800	4000	52
7	1 1/4"	450	200-315	22000	25
8	1 1/4'	300	200-316	6200	30
9	1 1/4'	280	200-400	4800	32
10	1 1/4'	200	315-500	600	30
11	1 3/4'	250	315-600	1500	35

PROCEDURA E KONTROLLIT DHE TE PASTRIMIT TE KOLEKTOREVE

1) INSPEKTIMI VIZUAL DHE VEPRIMET

Faza e parë, e domosdoshme për një planifikim të saktë të punimeve dhe për organizimin e vendit të ndërtimit, është ekzekutimi i një inspektimi vizual të koleksionistëve, objektit të projektit të restaurimit dhe të një studimi të saktë të të njëjtit, për verifikimin e karakteristikave teknike – logjistikën e vendit të ndërtimit dhe përcaktimin e materialeve të nevojshme. Të dhënat e mbledhura do të lejojnë përgatitjen e një programi pune, i cili do të dakordohet me Dekretin Legjislativ, bazuar në nevojat operacionale të sheshit të ndërtimit

2) INSTALIMI I PËRSHTATSHËM IMPIANTI I BY-PASS

Para se të filloni çdo punë brenda një tubi, ky i fundit do të vihet jashtë funksionimit, domethënë, i izoluar nga rrjeti të cilit i përket.

Ky operacion do të kryhet duke përgjuar ujin e bartur në rrjedhën e sipërme, me anë të balonave pneumatik të grilave, të cilat do të vendosen në korrespondencë me të gjithë tubacionet, të lidhura në rrjedhën e sipërme me atë në të cilën duhet të kryhen ndërhyrjet, ose me anë të punimeve të dimensioneve të përshtatshme.

Në këtë mënyrë, një pjesë e tubit do të izolohet.

Këto balona të grilave do të pozicionohen me dorë në grykën e tubit nga një operator.

Uji që mbërrin nga mali, drejt pikave ku do të jenë pozicionuar balonat e qepenave, duhet të ngrihet dhe të transportohet në seksionin e rrjedhjes së poshtme, përtej seksionit të tubit, ku do të kryhen punimet e riparimit.

Bazuar në një llogaritje kritike të rrjedhës, e cila do të duhet të marrë parasysh situatën më të rëndë të shiut, do të ketë madhësinë e një sistemi pompimi.

Një impiant i till impiant I tillë, do të përfshijë gjithashtu pompa rezervë, në rast se duhet të ndodhë një bllokim i sistemit kryesor.

Impianti do të monitorohet vazhdimisht nga një personel i kualifikuar, i aftë të ndërhyjë në rast të bllokimeve ose avarive të ndryshme, për aq kohë sa sistemi i pompimit do të funksionojë.

Sistemi i pompimit do të jetë në gjendje të ngrejë rrjedhën hyrëse nga rrjedhja e sipërme, me anë të tubave thithës, dhe t'a transportojë atë drejt luginës për shkarkim.

Tubat e dorëzimit dhe thithjes do të kenë një seksion të përshtatshëm për shkallën e rrjedhës dhe integriteti i seksioneve të tubave të përdorur do të monitorohet vazhdimisht.

3) PASTRIMI I KOLEKTORËVE ME SISTEMET HIDRO-MEKANIK

Kolektorët do t'i nënshtrohen një operacioni pastrimi, në mënyrë që të heqin depozitat e pranishme dhe për këtë arsye të lejojnë një aplikim të saktë të materialeve.

Metodologji të ndryshme do të përdoren sipas madhësisë së kolektorit dhe shkallës së depozitave të pranishme.

Puna e pastrimit mund të kryhet në mënyrë hidrodinamike me anë të kamionëve të kanalizimeve të një kapaciteti dhe fuqie të përshtatshme, të pajisura me mjete të llojeve të ndryshme sipas nevojave ose manualisht nga operatorët brenda kolektorëve, nëse shkalla e depozitave do të jetë e tillë, që të bëjë ndërhyrjen joefektive mekanike dhe hapësira dhe kushtet e disponueshme, të jenë të tilla që të lejojnë punimet, brenda kolektorëve.

Në përfundim të disa ndërhyrjeve të tilla, kolektorët do të jenë të përshtatshme për aplikimin e tubit të ri.

4) INSPEKTIMI PARAPRAK TELEVIZIV + PERFUNDIMTAR

Para fillimit të punimeve rehabilituese, do të kryhet një kontroll i saktë paraprak televiziv, me qëllim verifikimin e performancës së mirë të pastrimit dhe kushteve të sipërfaqes së brendshme të kolektorëve.

Ky inspektim, do të bëhet me anë të një aparati fotografik të montuar në një karrocë lëvizëse të drejtuar me tel të lidhur në një stacion për përpunimin e të dhënave të fituara ose manualisht me operatorët brenda, nëse dimensionet dhe kushtet e mbledhësve janë të tilla që nuk lejojnë arritjen e një cilësie optimale të imazhit.

Inspektimi televiziv do të identifikojë dhe do të lokalizojë numrin, shtrirjen dhe vendndodhjen e hyrjeve të ujit si dhe gjendjen e degradimit të tubit.

Ndriçimi do të lejojë shikimin e të gjithë sipërfaqes së brendshme të kolektorëve.

Kamera do të jetë me ngjyra, me një ekran me rezolucion të lartë me ndriçim të integruar 60 Watt dhe një gamë lëkundjeje prej 270 °, si dhe një kënd rrotullimi mbi 360 °.

Prandaj, kamera mund të operohet në të gjitha pikat brenda kolektorëve, duke e treguar atë prapa në drejtim të pikës së hyrjes.

Të dhënat e fituara do të mblidhen në VHS, fotografi të detajeve të që na interesojnë më shumë si dhe raporteve të planit skematik, në shkallë.

Në përfundim të punimeve, do të kryhet një inspektim i fundit televiziv, për të verifikuar zbatimin e saktë të sistemit të lidhjes.

Ky inspektim do të bëhet sipas procedurave të përcaktuara me siper .

5) TESTET E KOLEKTOREVE TE PASTRUAR

Në përfundim, testet e rrjedhjeve do të kryhen sipas parashikimeve të standardeve të UNI EN 1610, duke e mbajtur seksionin nën presion, pas izolimit me balona qepenash në 0,5 bar për 30 minuta ose me një kokë minimale prej një metër mbi ekstraktin e tubacionit, ose në përputhje me ASTM F 1216-05 "Praktikë standarde për rehabilitimin e tubacioneve ekzistuese dhe përçuesve nga ana e përmbysjes së një tubi të ngopur me rezinë".

Një kusht i domosdoshëm është që seksioni që po meret në shqyrtim, të jetë pa pengesa dhe pengesa të mos ketë hyrje anësore brenda tij, të cilat, nëse është e nevojshme, duhet të vulosen në mënyrë të përshtatshme për kohëzgjatjen e të gjithë operacionit.

Më pas u vendos për këto çështje:

Vlefshmëria e ofertës 150 ditë.

Kriteret e vlerësimit: Është çmimi më i ulët i ofruar.

Afatet e ekzekutimit janë : Brenda nje afati 2 vjecar

Komisioni unanimisht bëri miratimin e tyre dhe u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave, në Sistemin Elektronik.

NJESIA E PROKURIMIT

ANIJA VJERI

LAERT ILJAZI

ALGERT BAJRAMI